



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raport¹

mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të de-euroizimit

Gusht 2021

¹ Ky raport publikohet në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, nënshkruar më 18.4.2017 dhe publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| I. Hyrje..... | 3 |
| II Përmbledhje..... | 3 |
| III Ecuria e treguesve | 4 |
| IV Konkluzion..... | 13 |
| <i>Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të de-euroizimit (Shkurt 2018), dhe treguesit e monitorimit</i> | <i>14</i> |
| <i>Aneks II. Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit..</i> | <i>16</i> |
| <i>Aneks III: Vrojtimi për përdorimin e euros në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, kryer nga Banka Qendrore e Austrisë.....</i> | <i>17</i> |

I. Hyrje

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, si dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase. Paketa e masave, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përbëhet nga tre elemente kryesore: i) diferencimi i rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë; ii) kërkesa më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; dhe iii) ndërgjegjësimi i huamarrësve për rrezikun që paraqet kredia në valutë. Efikasiteti i masave monitorohet përmes disa treguesve dhe vlerësohet në bazë të ndryshimit në nivelin e euroizimit të sistemit financiar, para dhe pas implementimit të tyre. Më shumë detaje lidhur me masat dhe treguesit e përcaktuar për monitorimin e efektit të tyre, jepen në Aneksin 1.

Rezultatet e këtij vlerësimi, si dhe gjykimi mbi përshtatshmërinë e masave për arritjen e objektivit (nxitja e përdorimit më të madh të monedhës kombëtare në ekonomi) komunikohen çdo gjashtëmuor, përmes publikimit të këtij raporti.

Sikurse theksohet në Memorandum, synimi i Strategjisë nuk është arritja e nivelit zero të përdorimit të monedhave të huaja, pasi niveli i hapjes së ekonomisë sonë me vendet partnere tregtare nënkupton praninë e rëndësishme të monedhave të huaja në sistemin tonë financiar. Objektivi është pakësimi i përdorimit të monedhave të huaja deri në një nivel që konsiderohet i natyrshëm për një ekonomi të ngjashme me atë shqiptare.


II Përmbledhje²

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2021, ka vijuar zhvendosja graduale e treguesve drejt niveleve më të ulëta të rrezikut, kryesisht të krahut të aktiveve të sektorit bankar. Në terma vjetorë, kjo zhvendosje është më e dukshme edhe pse situata e krijuar nga pandemia ka vështirësuar vlerësimin e madhësisë së ndikimit. Treguesi kredive në valutë ndaj totalit të kredive ka rënë nën 50% për herë të parë duke shënuar nivelin minimal të viteve të fundit. Përmirësim kanë shënuar edhe kreditë e ekspozuar ndaj kursit të këmbimit të cilat i janë kthyer niveleve minimale të shënuar përpara pandemisë. Nga ana tjetër, pesha e depozitave në valutë ka shfaqur pak lëvizje, duke u luhatur rreth nivelit 51%. Duke konsideruar zhvillimet e përgjithshme ekonomike dhe financiare, veçanërisht në kushtet e pandemisë, mund të jetë koha që autoritetet të intensifikojnë përpjekjet për identifikimin e masave shtesë për rritjen e përdorimit të monedhës vendase në ekonominë reale dhe në sistemin financiar.

² Treguesit e monitoruar në këtë raport paraqiten të zhveshur nga efekti tremujor i luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj monedhave kryesore të huaja (euro dhe dollar amerikan). Për matjen e efektit të kursit në portofolin e kredive të secilës bankë është përdorur formula: $X_{t0} - X_{t-1} - (X_{t0}/K_{t0} - X_{t-1}/K_{t-1}) * K_{t-1}$. Ku, X përfaqëson vlerën në monedhën vendase, K është kursi i këmbimit i shprehur në lekë për njësi të valutës, dhe t është periudha e shprehur në tremujor.

Krahasuar me fundin e vitit 2020, në fund të qershorit 2021 janë vënë re këto ndryshime:
Depozitat – depozitat në valutë ndaj totalit të depozitave të klientëve shënuan nivelin 50.9%, njësoj si në fund të vitit 2020 dhe 1 pikë përqindjeje (pp) më poshtë se një vit më parë. Ndërsa, depozitat mbi një vit në monedhën vendase kanë ruajtur nivelin 14.2%;
Likuiditeti – aktivet likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë për sistemin, shënuan nivelin 31.6%, me një rënie prej 1.2 pp krahasuar me një vit më parë;
Kreditë – rreth 49.9% e portofolit të kredive është në valutë, ose 2.8 pp më pak se një vit më parë. Kreditë e pambuluara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përbëjnë 41.3% të kredive në valutë, pothuaj në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Grafik 1. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Për secilin tregues, niveli i rrezikut është përcaktuar duke iu referuar një pragu krahasues. Për treguesit “depozita në valutë ndaj totalit të depozitave” dhe “kredi në valutë ndaj totalit të tepicës së kredisë”, pragu krahasues është niveli prej 30%, sipas gjykimit ekspert. Për vlera nën 30% të këtyre treguesve, niveli i rrezikut konsiderohet “i ulët” (ngjyra e gjelbër). Për treguesin “aktive likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë”, pragu krahasues llogaritet duke i shtuar një devijim standard të serisë kohore kufirit rregullator prej 20%. Për vlera më të ulëta se ky prag krahasues, treguesi sinjalizon “nivel të lartë” të rrezikut. Për treguesin e “depozitave me afat mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë”, pragu krahasues është përcaktuar sipas gjykimit ekspert në nivelin 40%.

III Ecuria e treguesve³

Në këtë pjesë përshkruhet ecuria e treguesve të listuar në Aneksin 1 të këtij materiali. Paraqitja e treguesve të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit synon afrimin maksimal drejt matjes së ndikimit të masave. Ashtu siç është paraqitur në vijim, lajmërimi i paketës së masave nuk ka pasur efekt të menjëhershëm mbi treguesit e analizuar. Megjithatë, vërehet një prirje e përgjithshme në kahun e pakësimit të përdorimit të valutave.

³ Në këtë analizë janë rishikuar vlerat e T3 dhe T4 2018 për të reflektuar ndryshimet strukturore në sistemin bankar. Efekti i tyre ka qenë minimal dhe nuk ka pasur ndikim në konkluzionet e analizës.


Ecuria e Depozitave

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2021, treguesi që mat *peshën e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave* ka vlerë të njëjtë me fundin e vitit 2020, në nivelin 50.9%. Ky nivel është 1.1 pp më i ulët krahasuar me një vit më parë.

Në këtë tregues, totali i depozitave (emëruesi) ka treguar rritje me 3.4% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 6% krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së totalit të depozitave, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 12.6%.

Rritje kanë pësuar edhe depozitat në valutë (numëruesi) me 3.5% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 3.9% krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së depozitave në valutë, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 16.2%.

Grafik 2. Raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për sistemin bankar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për periudhën, treguesi i peshës reflekton një shpërndarje relativisht simetrike, duke u luhatur në nivelet 42.9% deri në 60.5%.

Aktualisht rezulton se 7 nga 12 banka që operojnë në sistemin bankar shënojnë nivelin mbi 50% për këtë tregues, duke i bërë ato subjekt të normës më të lartë të rezervës së detyrueshme (20%) për pjesën e depozitave në valutë që kapërcen peshën 50% ndaj totalit të depozitave. Për pasojë, këto banka duhet të përballen me kosto financiare më të larta për mbajtjen e valutës në ato nivele. Megjithatë, për shkak të normave shumë të ulëta të interesit për investimin e valutës, kostot për bankat janë relativisht më të ulëta se në një rast të kundërt.

Gjatë periudhës, treguesi i peshës ka pësuar rënie për 5 prej bankave të sistemit, duke shënuar një vlerë më të ulët se mesatarja e sektorit. Në tërësi, shpërndarja e vlerave të treguesit për bankat jepet në Grafikon 3.


Grafik 3. Shpërndarja e treguesit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në vijim, *peshë e depozitave në lek me afat maturimi mbi një vit ndaj totalit të depozitave* ka ruajtur një vlerë konstante me gjashtëmujorin e kaluar në nivelin 14.2%. Treguesi u tkurr gjatë periudhës me 0.1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 0.7 pp krahasuar me një vit më parë.


Grafik 4. Raporti i depozitave mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e treguesit të mësipërm sipas bankave konsiderohet e gjerë dhe reflektohet në vlerat e minimumit dhe maksimumit, të cilat variojnë nga 0.34% në 39.8%. Ndërkohë, 6 prej tyre e kanë vlerën e raportit më të lartë se vlera mesatare e sektorit.

Grafik 5. Shpërndarja e raportit të depozitave mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ecuria e Aktiveve Likuide

Ecuria e aktiveve likuide gjatë periudhës tregon se sektori bankar vijon të karakterizohet nga nivele të kënaqshme likuiditeti si në lek ashtu edhe në valutë. Duke iu referuar treguesit “aktive likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë” në nivel sektori, konstatohet se treguesi ka shfaqur një prirje rënëse përgjatë periudhës duke shënuar nivelin 31.6% në fund të qershorit 2021. Treguesi ka pësuar rënie me 1.2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe rritje me 1.3 pp krahasuar me një vit më parë.

Për periudhën, rënia e treguesit të sektorit është ndikuar nga rritja e aktiveve likuide në valutë (numëruesi) prej 0.3%. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së aktiveve likuide në valutë në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm rezultoi 56%, me ndikimin kryesor nga dollari amerikan.

Tek treguesi, ecuria e detyrimeve afatshkurtra në valutë (emëruesi) ka dhënë kontribut negativ sepse ka pësuar rritje me 4.1% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së detyrimeve afatshkurtra në valutë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar rezultoi 20.9%.


Grafik 6. Shpërndarja e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e vlerave të treguesit për valutën sipas bankave të sektorit (Grafiku 7) tregon se të gjitha bankat paraqiten mbi nivelin e kërkuar rregullator. Treguesi i peshës reflekton një shpërndarje relativisht simetrike e cila reflektohet edhe nga vlerat e minimumit dhe maksimumit, të cilat variojnë nga 21.2% dhe 40.7%.

Grafik 7. Shpërndarja e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, për bankat e sistemit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Kredisë

Bankat kanë rritur aktivitetin kreditues, pavarësisht presioneve negative të shkaktuara prej pandemisë Covid-19, ndikuar më së shumti nga ecuria e mirë e kredisë në lekë. Teprica e kredisë në valutë është tkurrur gjatë vitit të fundit me rreth 6.5 miliardë lekë, duke bërë që pesha e saj të bjerë në 49.9% në fund të qershorit 2021, rreth 2.8 pp më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.


Grafik 8. Raporti i kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ne grafikun 9 paraqitet shpërndarja e treguesit sipas bankave. Gjatë vitit të fundit, pesha e kredisë në valutë ka pësuar rënie në portofolet e të gjitha bankave të sektorit, gjë që reflektohet në një vlerë më të ulët të mesatares dhe të medianës së treguesit. Shpërndarja e treguesit ka ardhur duke u zvogëluar, siç evidentohet nga një ndryshesë ndërkuartilore më e vogël në fund të periudhës. Po ashtu, vlera maksimale ka shënuar një rënie domethënëse prej 7.6 pp. krahasuar me një vit më parë, duke qëndruar në nivelin prej 71.5% në fund të qershorit 2021. Pavarësisht zhvillimeve pozitive në drejtim të uljes së shkallës së euroizimit në portofolet e kredisë së bankave, për shumicën e tyre treguesi vijon të mbetet mbi nivelin mesatar të sektorit, gjë që i bën ato më të ekspozuara ndaj luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit.

Grafik 9. Shpërndarja e raportit të kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndër kreditë në valutë, kreditë më të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit janë ato ku të ardhurat e subjektit huamarrës janë në monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë (kreditë e pambrojtura në valutë). Në fund të gjysmës së parë të vitit 2021, këto kredi përbëjnë 41.3% të kredisë në valutë, ku peshën më të madhe të portofolit e zënë kreditë e pambrojtura në monedhën euro (me 89.9%), ndjekur nga kreditë e pambrojtura në dollarë amerikanë (me 10.0%).

Pesha e kredisë të pambrojtura në valutë ka ndjekur një trajektore rënëse deri në tremujorin e parë të vitit 2021⁴, kur treguesi u rrit në vlerën 42.9%, ndikuar nga zgjerimi i kredisë së pambrojtur në euro me 7.6% në terma vjetorë. Kjo rritje u frenua ndjeshëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, duke bërë që treguesi të kthehet në nivele të ngjashme me një vit më parë. Kështu, në fund të qershorit 2021, bankat kanë në bilancet e tyre rreth 2.5 miliardë lekë më pak kredi të pambrojtur në valutë (kryesisht si rezultat i pakësimit të ndjeshëm të kredisë së pambrojtur në dollarë amerikanë me [-20.9%] në terma vjetorë).

Grafik 10. Raporti i kredisë në valutë të pambrojtura për rrezikun e kursit të këmbimit ndaj totalit të kredisë në valutë, për sektorin bankar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel bankash, konstatohet se treguesi ka ardhur në përmirësim (rënie) për shumicën e tyre. Vlera maksimale është ulur me 4.2 pp krahasuar me një vit më parë, në nivelin 88.7%, dhe shumica e bankave kanë një vlerë të treguesit nën mesataren e sektorit. Shpërndarja e gjerë e treguesit, siç paraqitet në grafikun 11, reflekton faktin që disa banka janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit.

⁴ Rritja e peshës së kredisë të pambrojtura në valutë në T4 2020, është ndikuar nga një rënie më e lartë e emëruesit në krahasim me numëruesin.

Grafik 11. Shpërndarja e peshës së kredive në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Borxhit Publik

Përdorimi i tepërt i valutës në borxhin publik, përmes transaksioneve financiare transmetohet dhe nxit përdorimin e valutës edhe në ekonominë reale duke kontribuar në drejtim të kundërt me përpjekjet për de-euroizimin. Për këtë arsye, ecuria e përbërjes së borxhit publik monitorohet si pjesë e kësaj analize.

Në fund të mars 2021⁵, vërehet:


- 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj (obligacione 3 vjeçare dhe 10 vjeçare);
- 2) rënie në masën 3.22% e peshës së detyrimeve në valutë të qeverisë shqiptare krahasuar me fundin e shtatorit 2020.
- 3) rritje e borxhit të brendshëm në masën 4.48% krahasuar me fundin e shtatorit 2020

Gjatë vitit 2020-2021 pesha e borxhit publik vazhdon të përbëhet rreth 50% nga monedha vendase, ndërkohë që ndiqet nga monedha Euro dhe USD. Në fund të tremujorit të parë, borxhi publik në monedhën vendase shënoi nivelin prej 51.3% ose 3.26 pp më e lartë se në fund të tremujorit të tretë të vitit 2020. Pjesa e borxhit të jashtëm, pavarësisht diversifikimit të viteve të fundit, vazhdon të dominohet në mbi 70% nga monedha Euro, duke e bërë të ndjeshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit EUR/LEK. Megjithatë, qëndrueshmëria e Lekut dhe lëvizja e kursit të këmbimit EUR/LEK përgjithësisht në

⁵ Të dhënat më të fundit të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë deri në momentin e publikimit të këtij raporti i referohen fundit të muajit mars 2021.

drejtim të kundërt me kursin USD/LEK, kanë prodhuar efekte neto të vogla, në peshën e borxhit të jashtëm.

Grafik 12. Ecuria e borxhit publik në lekë dhe valutë (boshti majtas), si dhe pesha e borxhit publik në lekë ndaj totalit (boshti djathtas)




Burimi: Të dhënat janë marrë nga faqja e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përpunuar nga Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Kursit të Këmbimit

Një kurs i ekuilibruar i këmbimit ndihmon në krijimin e një ambienti makroekonomik të stabilizuar. Në afat të gjatë, qëndrueshmëria e kursit të këmbimit ndihmon në stabilitetin financiar të vendit dhe rritjen e përdorimit të lekut nga operatorët ekonomikë. Në afat më të shkurtër, luhatshmëria e kursit të këmbimit ndaj situatave të ndryshme të stresit financiar ofron një mekanizëm të rëndësishëm mbrojtës për zhvillimet makroekonomike.

Grafik 13. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dy valutave kryesore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2021, lëvizjet në kursin e këmbimit të Lekut kanë qenë të ulta. Kundrejt euros, leku është mbiçmuar lehtë në dy 3-mujorët e fundit. Kjo ecuri përkon me sjelljen sezonale të viteve të fundit.

Kundrejt dollarit amerikan, në terma vjetorë, është vënë re një nënçmim i lehtë i lekut gjatë muajve të parë të vitit, duke reflektuar përgjithësisht ecurinë e kursit të këmbimit EUR/USD në tregjet ndërkombëtare.

IV Konkluzion

Referuar ecurisë së treguesve të përzgjedhur gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2021, vërehet se në përdorimin e valutës nga sektori bankar ka pasur ndryshime të lehta. Ndryshimin më të dukshëm e shënoi rënia e kredive të ekspozuara ndaj kursit të këmbimit, ndërkohë që kreditë në valutë zbritën për herë të parë nivelin nën 50% të totalit të kredive. Në anën e detyrimeve të sektorit bankar, pesha e depozitave në valutë ka mbetur relativisht e pandryshuar gjatë periudhës. Këto zhvillime tregojnë që deri tani veprimtaria bankare ka shfaqur ndjeshmëri të moderuar ndaj masave të marra nga Banka e Shqipërisë për rritjen e përdorimit të monedhës vendase (dhe uljen e përdorimit të valutës). Arritja në një konkluzion përfundimtar ndërlikohet në kushtet kur, gjatë periudhës, politikat ekonomike dhe bilancet e subjekteve, duke përfshirë edhe atë të sektorit bankar, janë ndikuar nga veprimet financiare dhe sjelljet e agjentëve ekonomikë të lidhura me pandeminë aktuale. Nëse efektet vijnë të mbeten të tilla dhe duke konsideruar zhvillimet e përgjithshme ekonomike e financiare, mund të lind nevoja për masa shoqëruese që synojnë të japin një ndikim më të madh në realizimin e objektivit.

Ndikimi i pandemisë, i konsiderueshëm dhe ndoshta përcaktues për periudhën që analizohet, duhet të jetë gjithësesi i përkohshëm në një afat më të gjatë. Për këtë arsye, vlerësojmë se është e nevojshme diskutimi për identifikimin e masave për uljen e niveleve të përdorimit të valutës, në mënyrë graduale, edhe në sektorin real të ekonomisë. Mbështetur në Memorandumin përkatës të Bashkëpunimit, Banka e Shqipërisë ripërsërit ftesën që edhe palët e tjera nënshkruese të konsiderojnë aplikimin e masave të tilla për tregjet dhe instrumentet që mbikëqyrin respektivisht.

Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të de-euroizimit (Shkurt 2018), dhe treguesit e monitorimit

Masa 1. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht zgjerimin e maturitetit në strukturën e detyrimeve të sistemit bankar, **Banka e Shqipërisë vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme⁶**, për kategoritë e përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:

- 7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë me afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;
- 5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë me afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;
- 12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë kur këto zënë nën 50% të totalit;
- 20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën e detyrimeve në valutë mbi 50% të totalit.

Monitorimi i efekteve të Masës 1 bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *raportit të depozitave në valutë, të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit ndaj totalit të depozitave;*
- *raportit të depozitave mbi një vit⁷ në lekë, ndaj totalit të depozitave në lekë;*
- *ecurisë së strukturës së borxhit publik.*

Masa 2. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, **Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë kërkesën minimale rregullative për aktivet likuide në valutë⁸** në nivelin 20% të detyrimeve afatshkurtra. Për aktivet likuide në lekë, raporti u ruajt në nivelin prej 15%.

Monitorimi i efekteve të Masës 2 do të bëhet nëpërmjet treguesit në vijim:

- *raporti i aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, të zhveshura nga efekti i kursit të këmbimit.*

⁶ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 7.2.2018, “Për miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”.

⁷ Ky tregues u konvertua për të shfaqur ecurinë e peshës së depozitave në lekë mbi një vit, si synim i drejtpërdrejtë i uljes së normës së rezervës së detyrueshme në lek.

⁸ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 7.2.2018, “Për një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Masa 3. Për rritjen e ndërgjegjësimit të huamarrësve në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë u ka kërkuar bankave⁹ që:

- në rastet kur klienti aplikon për kredi në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ka të ardhurat, bankat t'i propozojnë huamarrësit një kredi alternative në të njëjtën monedhë me të ardhurat e tij, si dhe ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rast nënçmimi të lekut dhe/ose rritjeje të normës së interesit (me vlera të përcaktuara);
- të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo ato që ristrukturohen rishtas), opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet që janë të dakorduara nga banka dhe huamarrësi.

Monitorimi i efektit të Masës 3 bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *kredia në valutë ndaj totalit të portofolit, zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *kredia në valutë e pambrojtur nga kursi i këmbimit, ndaj totalit të kredive në valutë, zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *rezultatet e vrojtimit të nivelit të përdorimit të euros në vendet e Evropës Qendrore e Juglindore (EQJL) që përgatitet një herë në vit nga Banka Qendrore e Austrisë (përfshihet vetëm në raportin e publikuar në verë).*

⁹ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 7.2.2018, “Për disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

Aneks II. Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit

| Nr. | Masa | Data e adoptimit/e zbatimit | Përshkrim |
|------------|---|---|--|
| 1. | Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit | Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, neni 15 | Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë), nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator. |
| 2. | Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë | Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 26.10.2011, dhe nr. 28, datë 27.3.2013 | Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%. |
| 3. | Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit | Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” | Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (+50%), për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës. |

Aneks III: Vrojtimi për përdorimin e euros në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, kryer nga Banka Qendrore e Austrisë.

Me qëllim vlerësimit të shkallës së përdorimit të euro-s në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, Banka Qendrore e Austrisë (*Oesterreichische Nationalbank*, shkurt *OeNB*) kryen që prej vitit 2007 vrojtimin periodik, i cili mbledh informacion mbi shkallën e zëvendësimit të monedhës vendase me euro-n në shtetet që janë pjesë e vrojtimit, si dhe aspekte të tjera që lidhen me pritshmëritë dhe opinionet e individëve. Aktualisht vrojtimi i OeNB-së kryhet në dhjetë vende, ndër të cilat gjashtë janë anëtare të BE-së¹⁰ dhe katër nuk janë anëtare¹¹, përfshirë këtu edhe Shqipërinë.

Vrojtimi ofron një burim informacioni gjithëpërfshirës mbi nivelin e euroizimit të aktiveve dhe detyrimeve të individëve, besimit dhe pritshmëritë e tyre ndaj euros dhe monedhës vendase, si dhe nivelin njohurive financiare që ata zotërojnë. Mënyra e ndërtimit të tij, lejon krahasime në kohë jo vetëm midis vendeve, por edhe midis grupeve sociodemografike. Gjithashtu, të dhënat në shkallë mikro që ky vrojtım nxjerr, ofrojnë informacion cilësor shtesë mbi përcaktuesit e euroizimit në vendet në shqyrtim.

Deri në vitin 2014, vrojtimi kryhej dy herë në vit dhe duke filluar nga viti 2015 frekuenca u reduktua në një herë në vit. Për kryerjen e vrojtimit përzgjidhen në mënyrë rastësore 1000 persona prej secilit vend dhe intervistohen. Kampioni i përzgjedhur përfshin popullatën e individëve mbi 14 vjeç dhe është përfaqësues në lidhje me moshën, gjininë dhe shpërndarjen rajonale.

Në kuadër të raportit të deeuroizimit, kemi përzgjedhur të evidentojmë disa tregues që lidhen me vlerësimin e besimit dhe pritshmërive të individëve ndaj monedhës vendase, si dhe me nivelin e njohurive financiare të tyre. Në vijim paraqiten treguesit e publikuar nga OeNB-ja në faqen e saj zyrtare të internetit¹².

Niveli i përgjithshëm i euroizimit për vendet pjesëmarrëse në vrojtım

Vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore janë karakterizuar nga një përdorım i gjerë i valutave në ekonomi dhe të euros në mënyrë të veçantë. Studiuesit kanë ndërtuar një tregues të përgjithshëm mbi shkallën e euroizimit të ekonomive pjesëmarrëse në vrojtım, duke kombinuar të dhëna mikro të vrojtimit që lidhen me mbajtjen e parasë fizike (cash) në euro si edhe me të dhënat makro të depozitave në valutë të individëve (Scheiber dhe Stix, 2009), më specifikisht sipas formulës: *[para fizike (cash) në euro për frymë + depozitat në valutë për frymë] / (totali i parasë fizike për frymë në qarkullim + totali i depozitave për frymë)*.

Në terma absolutë, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit shkalla e euroizimit të aseteve të individëve varion nga nivele mesatare deri në të larta për disa vende, edhe pse treguesi për shumicën prej tyre mund të ketë ardhur në rënie (Scheiber, 2019). Rezultatet e


¹⁰ Vendet anëtare në BE të përfshira në vrojtım: Bullgaria, Kroacia, Polonia, Rumania, Republika Çeke, dhe Hungaria.

¹¹ Vendet jo-anëtare në BE të përfshira në vrojtım: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

¹² Rezultatet e vrojtimit mund të gjenden në adresën:
<https://www.oenb.at/en/Monetary-Policy/Surveys/OeNB-Euro-Survey.html>

vrojtimet për vitin e fundit tregojnë që për Shqipërinë shuma e parasë fizike për frymë që mbahet nga individët në euro është rritur, duke u rikthyer në nivele të ngjashme me mesataren e vitit 2012-2013. Megjithatë, indeksi i përgjithshëm i euroizimit ka mbetur në nivele të qëndrueshme, gjë që është ndikuar nga qëndrueshmëria e lartë në përzgjedhjen e individëve për të ruajtur kursimet e tyre në euro. Përsa i përket vendeve të tjera, rënia e indeksit të euroizimit në disa prej tyre, lidhet kryesisht me uljen e qarkullimit të parasë fizike në euro, ndërkohë që niveli i euroizimit të depozitave ka qenë relativisht i qëndrueshëm.

Grafik 13. Indeksi i euroizimit



Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB


Besimi dhe pritshmëritë e individëve

Vrojtimi mbledh informacion për besimin e individëve ndaj euros dhe monedhës vendase, si dhe bën krahasimin mes tyre. Ai vlerëson besimin e individëve ndaj institucioneve: BE-së, institucioneve qeverisëse në vendet përkatëse, si dhe ndaj bankave. Gjithashtu, vrojtimi ndjek pritshmëritë e individëve për situatën financiare në familjet e tyre dhe më gjerësisht për situatën ekonomike në vendet e tyre të rezidencës.

Në përgjithësi, individët në Shqipëri kanë relativisht më shumë besim ndaj BE-së, institucioneve shtetërore dhe ndaj bankave, duke u renditur të parët për besimin e tyre, krahasuar me vendet e tjera pjesëmarrëse në vërtetim. Bie në sy fakti që secili prej treguesve të besimit në këto institucione paraqitet në rritje edhe gjatë vitit 2020, një vit i karakterizuar nga vështirësitë dhe përpjekjet e administrimit të krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Nga ana tjetër, këto rezultate rezultojnë të jenë më heterogjene në vendet e tjera.

Për sa i përket besimit të individëve që depozitat e tyre në sistemin bankar janë të sigurta, Shqipëria vijon të shënojë kuotat më të larta krahasuar me vendet e tjera, dhe ky besim ka ardhur në rritje gjatë vitit të fundit. Në lidhje me nivelin e besimit ndaj euros dhe monedhës vendase, individët në Shqipëri besojnë që monedha vendase do të jetë e qëndrueshme dhe e besueshme në pesë vitet e ardhshme, siç paraqitet në grafikun në vijim. Krahasuar me vendet e rajonit, ky nivel besimi është në nivele më të larta.

Grafik 14. Besimi në monedhën vendase sipas vendeve anëtare të BE-së (grafiku majtas); dhe vendeve kandidate apo potenciale për kandidate (grafiku djathtas)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Për llogaritjen e ecurisë janë përdorur mesataret e kampionit të secilit vend (-2.5 “jam plotësisht kundër,” 0 “jam neutral,” +2.5 “jam plotësisht dakord”). Të anketuarit u pyetën nëse janë apo jo dakord sipas shkallës 1 (plotësisht dakord) deri në 6 (plotësisht kundër) në lidhje me pyetjen: “Sa dakord jeni me shprehjen në vijim: Në pesë vitet e ardhshme monedha vendase do të jetë shumë e qëndrueshme dhe e besueshme.”

Megjithatë, kur të intervistuarëve u kërkohet të krahasojnë midis euros dhe monedhës vendase, individët më së shumti vijnë të përzgjedhin monedhën euro si më të besueshme dhe të qëndrueshme në të ardhmen. Vlerat pozitive në grafikun më poshtë tregojnë që vlerësimi i stabilitetit dhe besueshmërisë së euros është relativisht më i lartë në krahasim me monedhën vendase. Në rastin e Shqipërisë vërehet një trend përmirësues në drejtim të besimit ndaj lekut, megjithatë duket se viti i pandemisë e ka kthyer disi këtë trend. Gjatë katër viteve të fundit diferenca midis monedhës vendase dhe euros është ngushtuar dhe ka shënuar nivele më të ulëta krahasuar edhe me vendet e tjera të rajonit.

Grafik 15. Niveli relativ i besimit ndaj euros në krahasim me monedhën vendase për vendet anëtare të BE-së (grafiku në të majtë) dhe vendet kandidate apo potenciale kandidate (grafiku në të djathtë)



Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.


Shënim: Për llogaritjen e ecurisë janë përdorur mesataret e kampionit të secilit vend (-2.5 “jam plotësisht kundër,” 0 “jam neutral,” +2.5 “jam plotësisht dakord”). Të anketuarit u pyetën nëse janë apo jo dakord sipas shkallës 1 (plotësisht dakord) deri në 6 (plotësisht kundër) në lidhje me

pyetjen: “Sa dakord jeni me shprehjen në vijim: Në pesë vitet e ardhshme, euro kundrejt monedhës vendase do të jetë shumë e qëndrueshme dhe e besueshme.”

Njohuritë financiare të individëve në Shqipëri

Për vlerësimin e njohurive të individëve në secilin vend, vrojtimi përdor një metodë standarde të aplikuar gjerësisht edhe nga vende të tjera¹³. Vrojtimi adreson njohuritë e individëve në katër fusha kryesore: normat e interesit, norma e inflacionit, kursi i këmbimit dhe rreziqet financiare. Sipas vrojtimit, individët në Shqipëri kanë njohuri relativisht të kënaqshme përsa i takon rrezikut financiar. Ndërkohë, ata paraqiten relativisht të kufizuar në drejtim të njohjes së rrezikut të kursit të këmbimit, të normës së interesit dhe inflacionit. Për më shumë informacion referojuni grafikëve në vijim.


Grafik 16. Niveli i njohurive për normën e interesit sipas vendeve
(mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)



Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është: “Supozoni që keni 100 [njësi parash në monedhë vendase] në llogari kursimi dhe norma e interesit ishte 2% në vit. Duke injoruar çdo tarifë tjetër bankare, sa do të keni në llogarinë tuaj pas 5 viteve nëse do t’i linit paratë të shtoheshin në llogari: më shumë se 102, ekzaktësisht 102, më pak se 102 [njësi parash në monedhë vendase].”

Grafik 17. Niveli i njohurive për inflacionin sipas vendeve
(mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

¹³ Metoda e përdorur është prezantuar për herë të parë nga Lussardi dhe Mitchell Financial Literacy and Planning: Implications for Retirement Wellbeing, 2004.

Shënim: Pyetja e bërë është: “Supozoni që norma e interesit në llogarinë tuaj të kursimit ishte 4% në vit dhe inflacioni 5% në vit. Duke injoruar çdo tarifë tjetër bankare, pas 1 viti, do të mund të blini më shumë, ekzaktësisht njësoj, apo më pak se sot me paratë në këtë llogari?”
Nga tabela e rezultateve janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.

Grafik 18. Niveli i njohurive për kursin e këmbimit sipas vendeve
(mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është “Supozoni që keni marrë një kredi në euro. Më pas kursi i këmbimit për monedhën vendase zhvlerësohet kundrejt euros. Si do të ndikojë kjo në shumën e parasë në monedhë vendase që do t’ju duhet për të paguar këstin e kredisë? Pagesa e këstit rritet / qëndron e pandryshuar / ulet.”

Nga tabela e rezultateve janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.

Grafik 19. Niveli i njohurive për rrezikun financiar sipas vendeve
(mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)



Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është “Në rastin kur një investitor shpërndan paratë e tij në aktive të ndryshme, rreziku për të humbur para rritet / ulet / nuk ndryshon?”

Nga tabela e rezultateve janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.